

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	8 orë dëshmi për vdekjen e këngëtarit Giorgios Mazonakis, mjekja mohon akuzat
ADRESA	https://tpz.al/8-ore-deshmi-per-vdekjen-e-kengetarit-giorgios-mazonakis-mjekja-mohon-akuzat-i333035
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 21:30:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 21:14:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	924e4604b31f1b0cf08362ae1b7059763ba6632e287c64cf45f2aa1fcb2af4a5
TEKSTI	17fd24839d933e7582369e0eb0a643dbd898a86809c8a4196d0b6482834a832e
PAMJA	1a6d508953921d5d347e3482f231cf1047210752a100664d52f96ff575e493c7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d1379af51b9207749e4d62f59812a11ba1ff0adebdec6e5a513100e159710ed6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa0d8cfc8113ea79b7663cf26341788a60de665698217179c4b01fa71930ced4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d1379af51b9207749e4d62f59812a11ba1ff0adebdec6e5a513100e159710ed6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

19:09 Neutralizohet vatra e zjarrit në fshatin Andon Poçi të Gjirokastrës • 18:35 Panik në Stamboll/ Të shtëna me armë në një dyqan, 3 persona humbin jetën • 17:37 Ak

BALLKAN, 15 SEPTEMBER 2026, 23:14

8 orë dëshmi për vdekjen e këngëtarit Giorgios Mazonakis, mjekja mohon akuzat

tpz.al TPZ



Për rreth tetë orë ka zgjatur dëshmia e mjekes Ioanna Gaka, e cila, së bashku me bashkëshortin e saj, Ilias Theodoropoulos, ndodhet në qendër të hetimit gjyqësor për vdekjen e këngëtarit grek Giorgios Mazonakis.

Gaka qëndroi për rreth tetë orë në zyrën e hetuesit, ndërsa pas përfundimit të dëshmisë së saj, para tij u paraqit bashkëshorti i saj, gjithashtu i akuzuar në këtë çështje.

Pas përfundimit të dëshmisë së Theodoropoulos, hetuesi dhe prokurori do të vendosin nëse do të kërkojnë apo jo që dy të akuzuarit të qëndrojnë në paraburgim.

Të dy përballen me akuzën për vrasje me dashje, me dashje të mundshme, vepër penale e cila, në rast dënimi, mund të dënohet edhe me burgim të përjetshëm.

Dy mjekët u paraqitën sot, pak pas orës 13:00, para hetuesit, pasi më herët kishin përgatitur dhe dorëzuar me shkrim qëndrimet e tyre lidhur me çështjen.

Më pas nisi një seancë maratonë pyetjesh dhe përgjigjesh, ku hetuesi kërkoi fillimisht sqarime nga Ioanna Gaka për ngjarjet e ndodhura gjatë periudhës kritike, kur Mazonakis ndodhej në klinikën e saj në rrugën Karneadou në Athinë, për t'iu nënshtruar trajtimit me plazmaferëzë.

Gjatë dëshmisë, mjekja, e cila që në fazat e para të hetimit është vendosur në qendër të dosjes për shkak se kishte marrë përsipër kryerjen e trajtimit, ka mohuar plotësisht akuzat ndaj saj.

Sipas raportimeve, Gaka ka mohuar se ka kryer ndonjë veprim të paligjshëm apo me qëllim mashtrues dhe ka këmbëngulur se veprimet e saj kanë qenë në përputhje me ligjin dhe me procedurat mjekësore.

Në fokus 49 minutat kritike

ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë
Nga Preç Zogaj

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Messenger

Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tiera video

Një pjesë e rëndësishme e marrjes në pyetje është përqendruar te intervali prej 49 minutash, nga momenti kur është regjistruar sinjali i parë i alarmit të aparaturës së plazmaferezës deri në telefonatën drejtuar shërbimit të urgjencës EKAB.

Kjo periudhë konsiderohet një nga pikat kryesore të hetimit, pasi në dosje ndodhen të dhëna digjitale që pasqyrojnë funksionimin e aparaturës së plazmaferezës, përfshirë edhe kohën kur është regjistruar alarmi i parë.

Hetuesi ka kërkuar nga mjekja të japë sqarime mbi atë që ka ndodhur gjatë këtij intervali dhe mbi veprimet e ndërmarra pas sinjalizimit të parë të aparaturës.

Në dëshminë e saj, Gaka ka këmbëngulur se ka vepruar në përputhje me ligjin dhe se ka kryer të gjitha veprimet që parashikohen në rrethana të tilla.

Ajo ka mohuar gjithashtu çdo veprim të qëllimshëm dhe ka hedhur poshtë akuzat që lidhen me përgjegjësinë e saj për vdekjen e Mazonakis.

Mjekja ka deklaruar gjithashtu se klinika e saj në rrugën Karneadou funksiononte në përputhje me ligjin.

Tashmë, pas përfundimit të dëshmisë së saj, hetuesi po merr në pyetje bashkëshortin e saj, Ilias Theodoropoulos. Pas përfundimit të kësaj procedure, pritet që hetuesi dhe prokurori të vlerësojnë dëshmitë dhe materialet e dosjes për të vendosur mbi masën e mëtejshme ndaj dy të akuzuarve.

BALLKAN / 15 September 2026, 23:00

Shtohen masat e sigurisë në Hagë/ Policia paralajmëron shqiptarët: Do të konfiskohen flamujt me shtiza dhe objektet e rrezikshme

BALLKAN / 15 September 2026, 22:50

Detaji i ri që po hetohet për vdekjen e Mazonakis/ Fotoja e fshirë iu dërgua një personi ende të paidentifikuar

BALLKAN / 15 September 2026, 22:29

Prishtina nuk fle sonte! Nis nata e pritjes për vendimin e Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së

BALLKAN / 15 September 2026, 22:02

Marta Kos: Nuk negociojmë për dinjitetin e viktimave të gjenocidit, Serbia duhet të përballet me të kaluarën

BALLKAN / 15 September 2026, 21:57

Qindra shqiptarë mbliidhen para Gjykatës Speciale në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

BALLKAN / 15 September 2026, 20:48

Shtohen masat e sigurisë në Hagë para vendimit për Thaçin, Veselin, Selimin dhe Krasniqin

BALLKAN / 15 September 2026, 19:46

Miliona euro nga buxheti i Kosovës për të akuzuarit në Hagë/ Ja sa është paguar për mbrojtjen juridike

BALLKAN / 15 September 2026, 19:24

Kosova në fokusin e NATO-s/ Këshilli i Atlantikut të Veriut mbliidhet, KFOR-i: Gati për çdo skenar

BALLKAN / 15 September 2026, 18:49

Verdikti i Hagës, udhëzimi i Komunës së Prishtinës për shkollat: Ora e parë t'i kushtohet UÇK-së

BALLKAN / 15 September 2026, 18:10

Djali i Jakup Krasniqit mesazh para verdiktit të Hagës: Asnjë vendim nuk e ndryshon të vërtetën, UÇK-ja është historia jonë

BALLKAN / 15 September 2026, 17:46

Ish-shefi i Misionit të OSBE-së flet para verdiktit të Hagës: Jam në ankth, procesi ishte politik

BALLKAN / 15 September 2026, 16:32

Nesër trazira në Kosovë? Franca paralajmëron shtetasit: Shmangni daljet në rrugë

BALLKAN / 15 September 2026, 14:22

Rama uron Kurtin për mandatin e ri: Të përshpejtojmë rrugëtimin drejt familjes europiane

BALLKAN / 15 September 2026, 12:34

Kriza politike në Kosovë, SHBA e pakënaqur: Po pengon axhendën e përbashkët

BALLKAN / 15 September 2026, 12:01

Shuhet Flora Brovina, aktiviste për të drejtat e njeriut, mjeke, poete dhe ish deputete e Kosovës

BALLKAN / 15 September 2026, 11:04

Qeveria e re e Kurtit në pikëpyetje, PDK e çon në Kushtetuese: U votua nga një Kuvend i pakonstituuar

BALLKAN / 14 September 2026, 22:33

LVV pas tërheqjes së Sejdiut: Kosova po dërgohet drejt zgjedhjeve të përsëritura

BALLKAN / 14 September 2026, 22:31

Fotografi e video të fshira nga telefoni i mjekes, detaje të reja nga vdekja e këngëtarit Giorgos Mazonakis

BALLKAN / 14 September 2026, 21:39

Greia i kërkon Parlamentit European heqjen e imunitetit të deputetit socialist të PASOK-ut, Nikos Papandreou

BALLKAN / 14 September 2026, 21:21

Rrahën brutalisht një person në Greqi, në pranga dy shqiptarë dhe një grek

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.



Built & Monetized by **Mediadesk**

AKTUALITET

IDE

NË FOKUS

BALLKAN

BOTA

LIFESTYLE

SPORT

TEJ E KETEJ

BLOG

EMISIONE

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.